

AJTEN HAJDARI-QAMILI SHQIPJA DHE VLLAHISHTJA NË QARKUN E STRUGËS

811.18:811.135.1 (497.772)

Gjuhët, sikurse edhe kulturat, rrallëherë e kënaqin vetveten. Nevoja e folësit për marrëdhënie ndërgjuhësore paraqitet kur një gjuhë është në kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me një gjuhë fqinje ose me gjuhën e folësve të cilët e kanë pushtetin, forcën apo kulturën sunduese. Kjo marrëdhënie mund të jetë miqësore apo armiqësore, sepse mund të ndikojë për zhvillimin e ndonjë biznesi ose të konspirojë në shkëmbimin e vlerave shpirtërore (shkencë, religjion), por edhe mund të ndrydhë apo të shuajë një gjuhë dhe kulturë të tërë.

Vështirë është të thuhet se një gjuhë ose dialekt është tërësisht e izoluar dhe nuk ka asnjë marrëdhënie me ndonjë gjuhë tjetër, sepse të gjitha kulturat në botë kontribuojnë me diçka dhe gërshtohen në mes veti. Megjithatë, dihet se rëndom ndikim më të madh ka gjuha e popullit që llogaritet si qendër e kulturës. A mendohet gjithmonë se natyra dhe shtrirja e fjalëve të huaja plotësisht varen nga të dhënat historike të marrëdhënieve kulturore mes gjuhëve? Përgjithësisht mendohet se një gjuhë merr nga një gjuhë tjetër më shumë fjalë, nëse folësit e atyre gjuhëve kanë marrëdhënie më intime, megjithatë, jo gjithmonë kjo është e saktë.

Çështja e burimit dhe lidhjes së shqipes dhe rumanishtes (si nënë e vllahishtes) daton qysht në shek XVIII kur gjuhësia ende nuk kishte ndërtuar metodologjinë shkencore që t'i qaset me tërë seriozitetin e saj kësaj çështjeje kaq të ndërlikuar. I pari që filloj të flasë për pikëtakimet mes shqipes dhe rumanishtes ishte J. E. Thunmani. Më pas paraqitet një plejadë e tërë shkencëtarësh, të cilët merreshin me këtë çështje, por u ndanë në dy grupe me qëndrime të kundërtta. Të parët, mes të cilëve J. B. Kopitari, K. Pauli, F. Milkoshiçi, T. Kapidani, J. Aurel Kandrea, Al Roseti, G. Vajgandi, V. Georgievi, K. Trajmeri etj. e përkrahin tezën se shqiptarët dhe rumunët kanë substrat të përbashkët etnik nga trakishtja; ndërkaj grupi tjetër, mes të cilëve B. P. Hashdeu, G. Mejeri, J. E. Thunmani, O. Densushianu, K. Sandfeldi, S. Pushkariu, L. Shaineanu. N. Jokli, E. Çabeji, Sh. Demiraj etj. e mbështesin tezën se të gjitha fjalët paralatine në rumanishte janë marrë nga shqipja dhe se gjithçka që është paralatine në rajonin karpato-ballkanik quhet *shqipe*, që do të thotë se në rumanishte nuk ekzistojnë elemente autoktone të trashëguara nga substrati trako-dak dhe se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe jo të trakasve.¹

Ka edhe disa shkencëtarë që përpiken të gjunjë një mes të të dyja tezave, se shqiptarët kanë prejardhje iliro-trake, prandaj kanë elemente të përbashkëta me rumunët, por ja që teza e tyre nuk ka shumë përkrahës dhe pasardhës, sepse mendimi i tillë mbetet vetëm në rrafshin e supozimeve pa asnjë fakt për t'u mbështetur.²

¹ Për këto më gjërësisht shihni: Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Rilindja, Prishtinë, 1976; Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Rilindja, Prishtinë, 1989 dhe Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994.

² Nga disa shkencëtarë të vrullshëm, për arsyeb subjektive, ende bëhen përpjekje që të imponojnë mendimin se shqiptarët nuk janë autoktonë në këto troje dhe se nuk kanë asnjë lidhje me ilirët, por një numër i madh i shkencëtarëve, mes të cilëve edhe

Duke rrumbullakuar thëniet e gjuhëtarëve, indoeuropeistëve dhe ballkanologëve të lartpërmendur të shek. XIX dhe XX, mund të përmbyllim se ato janë të ndryshme për nga interpretimi i problemit, që gjithsesi se janë varur nga niveli i zhvillimit të vetë gjuhësë si shkencë në këto periudha, nga përgatitja e tyre teorike, nga njohja vetëm e pjesërishtme e disa prej gjuhëve ballkanike, e deri edhe nga anshmëria e tyre vetjake, megjithatë ajo që është e përbashkët për të gjithë është se shqipja dhe rumanishtja kanë elemente të përbashkëta dhe formojnë Bashkësinë gjuhësore ballkanike (siç e quan Hashdeu).

Elementet e përbashkëta mes shqipes dhe rumanishtes nga disa gjuhëtarë shpjegohen si huazime nga shqipja, nga disa të tjerë si rezultat i ndikimit të idiomës së pararomanizimit të popullit latin në Daki. Në traditën historike të kërkimeve dhe hulumtimeve të gjenezës së elementeve të përbashkëta të shqipes dhe rumanishtes pranohet hipoteza e huazimit reciprok dhe se këto elemente në mënyrë të pavarrur janë trashëguar nga gjuha e tretë (qoftë nga ilirishtja, trakishtja apo dakishtja) në të dyja gjuhët.¹

Sipas Kopitarit, elementet e përbashkëta gjuhësore të gjuhëve ballkanike burojnë nga ilirishtja dhe trakishtja, ndërkaq Vajgandi prejardhjen e një numri të madh të ballkanizmave i llogarit si trako-shqipe (Demiraj 1989: 56). Sipas Mikloshiqit fjalët e përbashkëta të shqipes dhe rumanishtes nuk janë me burim grek, latin, sllav, turk apo nga ndonjë gjuhë të huaj, por janë trashëguar nga një fazë e hershme e evoluimit të tyre. Për veçoritë e përbashkëta mes shqipes dhe rumanishtes Vajgandi mendon se elementet latine në rumanishte nuk kanë depërtuar drejtpërdrejt, por përmes shqipes (Çabej 1976: 76).

Siç po shohim, për burimin e elementeve të përbashkëta mes shqipes dhe rumanishtes janë dhënë mendime të ndryshme, por ne në këtë kumtesë, do të trajtojmë vetëm lidhjet e shqipes dhe vllahishtes (si dialet i rumanishtes) në Strugë, duke i numëruar veç e veç tiparet e përbashkëta gjuhësore që ende gjallojnë.

Shqipja dhe vllahishtja qysh moti kanë pasur lidhje të ngushta historike-gjuhësore. Këto lidhje ndërgjuhësore kanë zgjatur deri sa mes tyre kanë depërtuar popuj të tjerë, domethënë, deri atëherë kur pjesa më e madhe e dakëve u romanizuan dhe u tërroqën në veri, kurse ilirët u tkurrën dhe rrudhën në pjesën jugperëndim të Ballkanit. Bashkëjetesa e tyre mundësoi që përmes simbiozës dhe interferencës të kenë aq shumë lidhje të ngushta gjuhësore, saqë kanë krijuar një fjalor të përbashkët. Këto fjalë ruhen në të dy gjuhët edhe sot e kësaj dite. Ato janë gjurmë evidente të vjetra më shumë se dy mijë vjet dhe janë faktorë të rëndësishëm kulturorë dhe shpirtërorë.

Sipas klasifikimit gjenealogjik të gjuhëve, shqipja është gjuhë indoeuropeiane sikurse edhe vllahishtja. Në krahasim me shumicën e gjuhëve, të cilët kanë grup të madh të gjuhëve simotra, shqipja formon grup më vete, kurse vllahishtja është dialet i rumanishtes e kjo e fundit është nëndegë e gjuhëve rumune. Sipas klasifikimit tipologjik (morfologjik), shqipja është gjuhë flektive sintetike-analitike (me prirje drejt analitizmit), sepse funksioni i emrave në fjali shprehet e dyfishuar: me rasa dhe me parafjalë. Ndërkaq, vllahishtja është më shumë analitike, sepse dukshëm janë zhvilluar tendencat ballkanike dha tash ka një lakim kryesisht analistik. Sipas klasifikimit arealor (gjeografik) edhe shqipja edhe vllahishtja janë gjuhë ballkanike, pra bëjnë pjesë në Bashkësinë gjuhësore ballkanike së bashku me greqishten, maqedonishten, bullgarishten, turqishten e Ballkanit ose Rumelisë dhe të folmet jugore të serbishtes. Shqipja ndahet në dy dialekta (toskërishte dhe gegërishte), pastaj në nëndialekta (gegërishtja veriore, gegërishtja jugore, toskërishtja veriore, toskërishtja jugore), pastaj në grupet e të folmeve (gegërishtja verilindore, gegërishtja veriperëndimore, gegërishtja qendrore, e folmja e Shqipërisë së Mesme, çamërishtja, labërishtja). Nga të

akademik Eqrem Çabej, me një numër të madh të fakteve dhe pa tendenciozitet argumentojnë se shqiptarët me ilirët i lidh gjuha, historia dhe vendi, kurse me trakasit vetëm elementet gjuhësore.

¹ Është e ditur se Bukureshti, Konstanca dhe Galaci kanë qenë fole shoqërore, kulturore dhe ekonomike e shqiptarëve. Rumunët qysh moti kanë qenë të interesuar për prejardhjen dhe jetën e shqiptarëve, sepse përmes tyre u njohën me vetveten. Këto dy kombe në momente të vështira e ndihmonin njëri-tjetrin, si askush tjetër.

gjitha këto nënndarje, shqipja e Strugës bën pjesë në gegërishten qendrore (konkretisht fshatrat në anën e majtë të rrjedhës së lumi Drini i Zi) dhe në toskërishten veriore (konkretisht fshatrat në anën e djathtë të rrjedhës së lumi Drini i Zi). Kurse rumanishtja ndahet në magalorumanishte, istrorumanishte, dakorumanishte dhe arumanishte ose vllahishte, pastaj vllahishtja ndahet në: veriore (Gramostenët dhe fiset e tjera shqiptare) dhe jugore (Pindeanët së bashku me të folmen vllahe të Olimpit) me një degë të veçantë të Frashërotëve. Sipas këtij degëzimi, në Strugë flitet e folmja frashëriote.

Vllehtë në Strugë kanë ardhur nga Shqipëria kryesisht nga fshatrat vlleha përreth. Gjatë shek. XIX në Strugë ka pasur vetëm pak familje vllahe. Dyndja më e madhe është bërë në gjysmën e dytë të këtij shekulli dhe atë më shumë nga fshatrat përreth. Përndryshe, sipas regjistrimit të vitit 1994 në Strugë ka pasur 545 vlleha (Марковиќ 2007:11).

Shpërngulja e vllehve në fshatrat e Strugës: në Belicën e Sipërme dhe në Belicën e Poshtme mund të ndahet në disa etapa. Grupin e parë e përbëjnë vllehtë e ardhur nga Çermenika (Shqipëria lindore), të cilët i kanë themeluar këto dy fshatra. Më vonë shpërngulen vlleh të tjerë nga Shqipëria dhe Epiri dhe më në fund një grup i madh nga qyteti Frashër (Shqipëria e mesme). Vllehtë e Strugës ndahen në frashëriotë, të cilët janë çobanë dhe në vlleh, të cilët janë vendas më të moçëm dhe tregtarë të shquar.¹ Në fillim kanë qenë të vendosur në fshatrat Belica e Sipërme (Beala di supra) dhe Belica e Poshtme (Bealla di goz), pastaj në Vevçan, Podgorcë, Llabunishtë dhe Vishnë. Por me kalimin e kohës, për shkaqe ekonomike dhe politike, janë shpërngulur në fshatin Misleshevë ose kanë zbritur në qytet në Strugë, Ohër, Shkup, Beograd dhe në vende të tjera. Por, më tragik është fakti se vllehtë e Strugës janë asimiluar për shkak të martesave të përziera me maqedonasit ose për shkak të politikave të njohura të ish-Jugosllavisë. Për këtë arsyesh rrallë vetë dinë ta flasin vllahishten, sepse në shtëpi flasin maqedonisht, bile edhe mbiemrat i kanë bërë me prapashtesat maqedonase –(o)ski ose –ov (*Baljuk-oski, Simak-oski, Kukunesh-oski, Zozo-ski* etj.).

Elementet e përbashkëta mes shqipes dhe vllahishtes (frashëriotishtes) në qarkun e Strugës pasqyrohet në të gjitha rrafshet gjuhësore: në atë fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore; duke filluar nga bashkëpërkimet më të lashta, si: përcaktorët e pavarur të prapavendosur, krijimi i nyjave të paravendosura dhe një numër i leksemave të vjetra. Domethënë, disa bashkëpërkime janë shumë të lashta ose janë trashëguar nga lidhjet shqiptare-rumune para shumë shekujve, kurse disa janë të reja dhe kanë shtrirje të ngushtë vetëm në trekëndëshin Strugë – Ohër – Frashër.

Në të folmen e frashëriotëve të Strugës janë ruajtur disa elemente të shqipes, të cilat kanë depërtuar shumë thellë dhe janë bërë shtyllë e gjuhës, megjithatë i kanë ruajtur edhe disa tipare veçuese me të cilat dallohen nga të folmet tjera vllahe. Ajo që më së shumti vërehet vetëm nga të dëgjuarit dhe që është krijuar në ndikim të shqipes është shqiptimi i fonemës /r/ me tendosje më të madhe e me katër dridhje dhe afrikatizimi i pjesërishëm i fonemës /q/.

Në vijim do t'i pasqyrojmë në veçanti bashkëpërkimet më të rëndësishme gjuhësore:

1. Bashkëpërkimet fonetike-fonologjike:

1. Zanorja /a/ e patheksuar e lat. në shqipe jep /ë/ edhe në vllahishte jep /ă/, p.sh.: *shëndet* = *sänätate*; *këmishë* = *kämašă* etj.
2. Para bashkëtingëlloreve hundore /a/-ja e lat. mbylljet në të dyja gjuhët, kështu që fitohet një /ë/ në shqipe dhe /ă/ në vllahishte: *këngë* = *käntec*, *këngëtar* = *käntätor*, *këmbë* = *kämp*.
3. Zanorja /u/ e shkurtër e lat. është ruajtur në të dyja gjuhët, p.sh.: lat. *exurtus* > shq. *shkurt* = vll. *skurt*, lat. *furca* > shq. *furkë* = vll. *furkă*, lat. *fundus*, shq. *fund* vll. *fund*.
4. Grupet bashkëtingëllore **ct** të latinishtes në shqipe kanë përfshuar **ft** ose **jt** ose **t**, ndërsa në

¹ Këto dy grupe nuk martoher mes veti.

vllahishte **pt**: lat. *lucta* shq. *luftë* vll. *luptă*, kurse grupi **cs** në shq. kalon në **fsh** ose **sh**, në vll. jep **ps** ose **s**, si p.sh.: lat. *coxa* > *kofsha, koapsă*.

5. Hasim evoluim të përbashkët të fjalës trerrokëshe të lat. *caballus* në fjalë njërrrokëshe në shq. *kalë*, në vll. *kal*.
 6. Bashkëtingëllorja /q/ ka shqiptim të afrikatizuar edhe në vllahishte në ndikim të të folmeve gege të Strugës.
 7. Në fshatrat gege dhe në të folmen frashëriote zanoret e theksuara diftongohen dhe kemi prani të diftongoideve: **eⁱ, i^e, "o, o^u, ēi**.
 8. Tipar krejtësisht i veçantë i të folmes frashëriote është tendenca e zhdukjes së diftongjeve, por jo edhe i diftongoideve. Këto janë të pranishme tek e folmja gege e Strugës, kurse tek e folmja toske dhe e qytetit nuk ka.
 9. Fonema /x/ ka përdorim të dendur në të dyja gjuhët, e cila nuk është karakteristikë e gjuhëve të tjera me të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë.
 10. Sonantet hundore vendosen para buzoreve /b/, /p/, /v/ e dhëmboreve /d/, /x/ dhe krijojnë grupet bashkëtingëllore hundore **mb**, **ng**, **nx** etj. në fillim të fjalës (*mbret ~ mbelă, mbi ~ mbatat, nderq ~ ndreg, nxënës ~ nxenă*).
- Është mjaft interesant fakti se kur një vllah nga Struga flet maqedonisht, tingëllon njëlloj sikurse edhe shqiptari kur flet maqedonisht, sepse mënyra e shqiptimit të disa fonemave, si: /q/, /x/, /ě/, pastaj diftongoidet e /e/-së dhe /i/-së, të theksuarit e rrrokjes parafundore etj., të cilat janë tipare të përbashkëta mes shqipes dhe vllahishtes, ndikojnë që në mënyrë të pavetëdijshme t'i përdorin edhe shqiptarët edhe vlehtë përderisa flasin maqedonisht.

2. Bashkëpërkime morfollogjike dhe morfosintaksore:

1. Ajo që është e njëjtë në të folmet shqipe dhe vllahe në Strugë është fjalëformimi i emrave të gjinisë femërore nga emrat e gjinisë mashkulllore, duke ua shtuar prapashtesat **-onjë = oaie**, p.sh.: *ulkonjë = ursoiae; arushë = ursoiae* etj.;
2. Ndajfoljet prejemërоре ndërtohen me ndihmën e prapashtesave **-isht = este**, p.sh.: *njerëzisht = omeneşte, çobanisht = ciobăneşte, arumunisht = rămăneşt*;
3. Pjesorja, gjegjësish supini përdoret për të ndërtuar të kryerën, në vend të paskajores gege (gjegjësish infinitivit në vll.): *është çmendur për të lidhur = nebun de legat*;
4. Prapavendosja e nyjës për shquarsi në shqipe është në përputhshmëri të plotë me një prirje shumë të lashtë për zhvendosje së bashku të të gjithë përcaktorëve të pavarur pas emrit edhe treguesi anaforik, prej nga edhe buron mbaresa (nyja) e shquarsisë në shqipe, e cila ka qenë e varur dhe e pavetëmjaftueshme dhe si e tillë është zhvendosur pas emrit: (*zan-i / zér-i i < (ki) zan*). Në mënyrë të njëjtë shpjegohet kjo dukuri në rumanishte, prej nga edhe në vllahishten e Strugës: (*un bărbat – bărbatu = burrë - burri*);
5. Mbiemri që përcakton emrin e shquar, qoftë edhe i përveçëm, qëndron gjithmonë pas emrit: *Uji i madh, Apa cea mare, vajzë e mirë, fetă mușată, Leka i madh, Alexandru cel mare,jeta e re*. Megjithatë në të folmet frashëriote hasen tri modele: emri + mbiemri (*fetă mușată*), mbiemri + emri (*bun om*), emri + nyja e shquarsisë + mbiemri (*omu aceu bun*). Kurse në të folmet shqipe të Strugës modeli i dytë mund të përdoret vetëm për të shprehur variante stilistike dhe nëpër fjalë të urta ose shprehje frazeologjike, kurse modeli i tretë fare nuk përdoret;
6. Është e njëjtë edhe mënyra e formimit të shumësit te disa emra ambigjenë, të cilat në njëjës janë në gjininë mashkulllore, kurse në shumës kanë formën e emrave të gjinisë femërore, si p.sh.: shq. (*pallat - pallate, mal - male, vend - vende*), vll. (*lok - lokuri, kuvânt - kuvinte, bilet - biletë* etj.);

7. Emri prejfoljur ka mbaresë të ngjashme, **-ri** (në vll.) dhe **-rje/-je** (në shq.): *purtari, lukrari, străcheri ≈ shkuarje, larje, marrje*;
8. Toponimet, të cilat në maqedonisht mbarojnë me **-o**, në shqip dhe në vllahisht në trajtë të shquar mbarojnë me **-a**: *Темово - Тетова, Куманово - Куманова, Кратово - Кратова* etj. (Атанасов 1997: 12 - 13);
9. Mbaresat e shquarsisë dhe pashquarsisë të emrave të gjinisë femërore që mbarojnë me **-ë**, janë të njëjta si në shqipe, ashtu edhe në vllahishte: **ă ~ a = ē ~ a** (*fetă ~ feta = vajzë ~ vajza, portă ~ porta = portë ~ porta*);
10. Për të shprehur shumësin e disa emrave të gjinisë mashkullore përdoret dukuria morfonologjike e qiellzorëzimit, si p.sh.: *lup ~ luk / ujk ~ ujq*;
11. Janë të pranishme emra që mbarojnë me bashkëtingëllore, dukuri e cila nuk është në asnje të folme tjetër vllahe, që tregon ndikimin e drejtpërdrejtë nga shqipja: *korb ~ korb, părumb ~ pëllumb, preft ~ prift, fum ~ tym*;
12. Kemi formim analog të shumësit tek emrat e gjinisë mashkullore me mbaresën **-ń**, gjegjësisht **-nj**, p.sh.: *kăni – kán, mi – minj, dru – drunj*;
13. Me mbaresën **-u** shquhen emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me **-k**, **-g**, **-h** dhe zanore të theksuar në shqipe, kurse në të folmen frashëriote përdoret për të gjitha emrat e gjinisë mashkullore, si p.sh.: *mik – miku, zog – zogu, krah – krahу, bari – bariu, ka – kau, Nuri - Nuriu ≈ pork – porku, korb – korbu, an – anu, andi – andiu, ou – bou*;
14. Në mënyrë identike formohet shumësi i emrave të gjinisë mashkullore që shprehin emra familjarë, pra me forma të veçanta: *tătă – tătăń ≈ baba – baballarë, păpu – păpăń ≈ dajë – dajallarë, lălă – lălăń ≈ lalë – lalanj / xhaxha – xhaxhallarë*.
15. Numërimi vigesimal (me zetëshe), i cili është një element paraindoeuropean në shqipe, ka depërtuar edhe në vllahishten frashëriote, d.m.th. për numrin 20 kemi fjalën: *ińăc ~ njëzet*, dhe jo numërim me dhjetëshe (dy+dhjetë). Kjo në shqipen e rrëthit të Strugës vazhdon edhe për numrin 40 (dyzet) edhe gegët, edhe toskët, edhe e folmja e qytetit.
16. Për të shprehur ritregim, vllahishtja e përdor habitoren, të cilën e ka marrë nga shqipja dhe e ka përshtatur sipas sistemit të vet gjuhësor. Ndërkaq, e dimë se habitoria e shqipes është një mënyrë e veçantë foljore, e cila formohet nga baza e pjesores, të cilës i shtohet folja ndihmëse **kam**. Prapashtesa **-ka** në vllahishte buron nga forma e vetës së tretë njëjës në kohën e tashme të foljes ndihmëse **kam** të shqipes dhe e njëjta është bërë formë e ngurosur dhe e pandryshueshme: **-ska / -cka**. Këto konstruksione kanë edhe forma të thjeshta, por përfshihen edhe në konstruksione të përbëra (Friedman 1994: 79-89). p.sh.: *Ti qenke njeri i pasur! Tini fuska avut om!?, Ti paske shtëpi të madhe!? Tini avuska mari kasă!?*
17. Ndërtimi i të kryerës (perfektit jam/kam) me foljet ndihmëse jam ose kam + pjesorja (participi), po ashtu është formuar në ndikim të shqipes dhe përpos në të folmen frashëriote, ka depërtuar edhe në të folmet perëndimore të maqedonishtes (prej aty edhe në maqedonishten standarde). p.sh.: *kam ardhur / jom a:rdh* (në gegërishten verilindore), *am vănită / esk vănit* (vll.), *имам дојдено / сум дојден* (maq.).
18. Krijimi i kohës së pakryer (imperfektit) dhe kohës së kryer të thjeshtë (aoristit) me foljet ndihmëse **kam / am** dhe **jam / esk** të cilat kanë edhe forma të aoristikë të përbërë, në vllahishten e Strugës është formuar në ndikim të shqipes.
19. Kategoria modale e gatishmërisë e cila shënon kohën e ardhme, por që shprehet përmes formave të së tashmes është e pranishme edhe në shqipe, edhe në vllahishte, por edhe në gjuhët e tjera ballkanike, p.sh.: *E ha bukën për një orë ≈ U ămpatur kampu ti ună unăxuă ≈ Го јадам лебов за еден час; In după cinci minuti ≈ Vij për pesë minuta ≈ Идам за пет минути*.

20. E njëjta folje e kryen funksionin edhe si kalimtare, edhe si jokalimtare. (*E gëzuan me një dhuratë ≈ U hărăsii pi hiluńu*). Edhe këtë tipar, përpos në vllahishte, e hasim në të folmet perëndimore të maqedonishtes, natyrisht në ndikim të shqipes. p.sh.: *Го радував (израдував) со еден подарок.*

21. Përputhen plotësisht edhe format që shprehin mënyrën kushtore (kondicionalin) në shqipe dhe vllahishte, por edhe në të folmen maqedonase të Strugës: *Të kisha pare, dë blesha shpi / T'kisha pare, dë gj'eshha shpëi ≈ Savem prax, u sânkupram kasă ≈ Да имав пари, ке купев куќа.*

22. Kohët e kryera dhe të kryerat e dyta (e kryera, më se e kryera, e kryera e tejshkuar, më se e kryera II, e kryera e tejshkuar II) në vllahishte është shumë e ndërlikuar, sikurse edhe në shqipe, sepse vllahishtja i ka marrë të gjitha këto forma nga shqipja dhe i ka përshtatur në sistemin e vet. Këto forma kanë depërtuar edhe në maqedonishte. (më gjërësish shih: Марковиќ 2007: 151). p.sh.: *ari lukrată – ka punuar – имат работено; ave lukrată – kishte punuar - имаше работено; avu lukrată – pati punuar – имал работено; ari avută lukrată – ka pasë punuar - (*имат имано работено); ave avută lukrată – kishte pasë punuar - (*имаше имано работено); avu avută lukrată – pati pasë punuar - (*имал имано работено);*

3. **Bashkëpërkime leksikore** – Shqipja ka lënë shumë gjurmë në leksikun e rumanishtes, e sidomos në të folmen frashëriote. Këtë ndikim mund ta ndajmë në tri periudha:

a) periudha shumë e lashtë para romanizimit: *avull ~ abur, bajgë ~ baligă, baltë ~ baltă, bardh ~ bardă, buzë ~ buză, cjap ~ tap, çukë ~ ciukă, droe ~ droaie, dhallë ~ zară, dhuratë ~ dar, fyell ~ fluiera, gardh ~ gard, gati ~ gat, gjemb ~ glimp, hamës ~ hames, kokë ~ koakaza, mal ~ mal, moshë ~ mos, nepërkë ~ năpărkă, përrua ~ paran, qafë ~ ceafă, rrufe ~ rimf, sorrë ~ cioara, shkrep ~ skăpară, thërrime ~ fărima, urdha ~ urda, vatër ~ vatră; etj.*

b) periudha pas romanizimit: *balash ~ bal'u* (kalë me njollë të bardhë në ballë), *banë / banoj ~ bană, gjizë ~ ǵiză, lara ~ l'ar, mendoj ~ minduesku* etj.

c) periudha më e re ku ndikimi i shqipes vërehet vetëm në të folmen frashëriote: *kanos ~ kănusesku, rrëzoj ~ răzuesku, rrok ~ rukuesku, avëlmënt ~ valment, dafinë ~ dafină, gushë ~ gusă, voe / vezë ~ oe /oia, flakë ~ flekă; grur ~ grân, flamur ~ flambura, shkuë ~ spuma, misër ~ misăr, skula ~ shkula, ǵela ~ gjellë, ıucădo ~ kudo, cineva, verdi ~ verdh, orfän ~ varfér, vorfën* (nga geg.) etj.

Numri i elementeve të përbashkëta leksikore mes shqipes dhe vllahishtes është shumë i madh, por më parë ka qenë edhe më i madh. Nuk duhet lënë anash mundësia se gjatë shekujve disa nga leksemat e përbashkëta kanë dalë nga përdorimi, qoftë në njëren gjuhë apo në tjetrën, ose edhe në të dyja gjuhët, por sipas analizës së Russu-së në 1970, ky numër ka qenë rreth 90-100 fjalë.

Një dukuri shumë karakteristike është forma e antroponimeve të rrëthit të Strugës, si p.sh.: *Pasku = Vellko (Велко); Stavri = Kërste (Крсме); Vangell = Vangjel = Bllagoja (Благоја); Sotir = Branko (Бранко)*, të cilat janë çifte sinonimike, por te vllehtë dhe shqiptarët kanë prejardhje romake, kurse te maqedonasit kanë prejardhje greke. Megjithatë duhet theksuar se në rrëthin e Strugës tash më nuk kanë mbetur shqiptarë të krishterë, sepse janë maqedonizuar, por nga mbiemrat e tyre dëshmohet se kanë qenë shqiptarë, si: *Prento = Përrenjas, Lusho = Lushnjë, Kavaj(oski) = Kavaja* etj.

Nga gjithë ç'u tha më sipër, po përmbyllim se të gjitha bashkëpërkimet fonetiko-fonologjike, morfollogjike, morfosintaksore dhe leksikore mes shqipes dhe vllahishtes së Strugës janë rezultat i bashkëjetësës shumëshekulllore të këtyre dy popujve dhe, siç u cek edhe më sipër, se shumica e elementeve të përbashkëta kanë hyrë nga shqipja, për shkak të faktorëve historikë, shoqërorë dhe gjeografikë, megjithatë duhet të nënvizojmë se interferanca gjuhësore në ditët e sotme ka pushuar së vepruari, ngaqë ndërmjetësues i këtyre dy gjuhëve është bërë maqedonishtja, për shkak të statusit zyrtar që ka.

SHKURTESA

shq. - shqip
vll. - vllahisht
lat. - latinisht
maq. – maqedonisht

TRANSKRIPTIM FONETIK

đ = xh
ų = /u/ hundore
ă = ē
ş = sh
x = x
ǵ = gj
ń = nj
ç = ч

LITERATURA E KONSULTUAR

Атанасов 1989- Македонска Академија на Науките и Уметностите, Петар Атанасов, *Фонолошкиот систем на магленороманскиот*, Скопје, 1989.

Атанасов 1997 - Годишен зборник на Филолошкиот факултет “Блаже Конески” на Универзитетот во Скопје, Книга 23, Петар Атанасов, Романско-албански јазични врски, Скопје, 1997.

Çabej 1976 – Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Rilindja, Prishtinë, 1976.

Demiraj, 1989 – Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Rilindja, Prishtinë, 1989.

Demiraj, 1994 – Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994.

Friedman A., 1994 – Victor A. Friedman, *Surprise! Surprise! Arumanian has had an Admirative!*, Indiana Slavic Studies, vol. 7, pp. 79-89, 1994.

Friedman A., 1996 – Victor A. Friedman, *A newly discovered grammatical form in the Arumanian dialect of Beala de Sus*, The Newsletter of the Society Farsarotul, Volume X, Issue 2, Trumbull CT, 1996.

Марковиќ 2007 – Марјан Марковиќ, *Ароманскиот и македонскиот говор од охридско-струшкиот регион (во балкански контекст)*, Скопје, 2007.

Ќамили 2008 – Ајтен Ќамили, *Социјалните варијанти на албанските струшки говори и меѓујазичната интерференција (кај еднојазичните, двојазичните и повеќејазичните говорители)*, магистерски труд одбранет на Филолошки факултет “Блаже Конески“ - Скопје (необјавен), Скопје, 2008.

Ќамили 2011 – Ајтен Ќамили, *Албанските говори од струшкиот регион (во балкански контекст)*, докторска дисертација одбранета на Филолошки факултет “Блаже Конески“ - Скопје (необјавена), Скопје, 2011.

Ќамили 2014 – Ајтен Ќамили, *Албанско-ароманските јазични врски“*. Годишен зборник, Книга 38, Скопје: Универзитет "Св. Кирил и Методиј" - Скопје, Филолошки факултет "Блаже Конески", 2014. 365-376.

Russu, 1970 - I Russu, *Limba traco-dacilor*, Bucuresti, 1970.